

Nenad Perosheviq
Millosh Vukanoviq

Jeta e partizanëve





Pyetja kyçe

Si e organizuan jetën pjesëtarët e lëvizjes partizane në territoret të cilat i çliruan?



Tema

Tema e përfshinë periudhën e tërë Luftës së Dytë Botërore (1941-1945) në hapësirat e Jugosllavisë. Tema dikur ka qenë mjaft e përfaqësuar dhe e trajtuar në detale në programin arsimor të Jugosllavisë komuniste, por pas shkatërrimit të saj ngadalë është zvogëluar në programet arsimore të shteteve të porsakrijtura. Aktivitetet e partizanëve në territoret të cilat i mbanin gjatë Luftës së Dytë Botërore deri soja janë kontroverse.



Qëllimet



Rezultatet e mësimit:

1. Nxënësit do t'i analizojnë burimet historike
2. Nxënësit do të mësojnë për lëvizjen partizane dhe jetën në territoret të cilat i kontrollonin gjatë Luftës së Dytë Botërore.
3. Nxënësit do të mësojnë për jetën e grave në lëvizjen partizane gjatë Luftës së Dytë Botërore




HYRJE

Pas fillimit të luftës në Jugosllavinë e okupuar (qershor-korrik 1941) nga ana e partizanëve, territoret e çliruara vazhdimisht zgjeroheshin dhe në dhjetor 1942 sipërfaqja e saj ishte më e madhe se sipërfaqja e vendeve të caktuara evropiane. Në territoret e çliruara shpejt u vendosën organe të reja të pushtetit administrativ, Këshillat Nacionalçlirimtare (KNÇ), si edhe strukturat e ekonomisë, arsimit dhe shëndetësisë. Caku final i luftës ishte çlirimi i Jugosllavisë nga okupatori por edhe vendosja e rregullimit të ri shoqëror komunist. Qëllimet e këtyra i sollën në konflikt krahas me okupatorin edhe me fraksionet e luajalëve të regjimit të vjetër, si edhe me grupet e porsakrijuara nacionaliste. Në territoret e çliruara të pushtetit të porsaformuar u munduan të vendosin disiplinë dhe kontroll mbi trupat e tyre, por kjo nuk i pengoi keqpërdorimet dhe incidentet e ndryshme.

SHTETI	SIPËRFAQJA km ²
BELGJIKA	30.000
ZVICRA	41.000
DANIMARKA	43.000
JUGOSLLAVIA (territoret e çliruara në vitin 1941)	48.000

Harta e territoreve të çliruara nga FÇP* nga viti 1941 deri në vitin 1944

*FÇP – Fronti Çlirimtar Popullor – me fjalë të tjera Lëvizja Partizane



Pyetje:

1. Cilat ishin hapësirat të cilat i çliruan partizanët?
2. Ku dhe në çfarë terrenesh lëviznin më së shumti?
3. A mund të numëroni disa prej zonave të Jugosllavisë të cilat i kontrolloni partizanët në vitin 1941, 1942, 1943 dhe 1944.

Burimi 1

Organizimi i pushtetit

Këshillat Nacionalçlirimtarë (KNÇ) ishin organe të pushtetit popullor revolucionar në Jugosllavi që i ngritën gjatë Luftës Nacionalçlirimtare (LNÇ) 1941-1945. Janë krijuar (zgjedhur ose emëruar) nga fillimi i kryengritjes së armatosur 1941 në territorin e çliruar e më vonë edhe në territorin e paçliruar, dhe që nga themelimi ishin bërthama e sistemit të ri shoqëror. Këshillat nacionalçlirimtarë nga themelimi kishin tipare të pushtetit të organeve shtetërore. Sillnin vendime dhe udhëzime, i zgjidhnin raportet e ndërsjella të qytetarëve, i përcaktonin të drejtat dhe obligimet, e përshkruanin sjelljen, e organizonin ndihmën për aradhet partizane dhe mbronin fillimin e rendit të ri. Përveç në territoret e çliuara dhe gjysmë të çliuara të Jugosllavisë, ata punonin edhe në prapavijën e armikut, në formë të këshillit të vetëm të frontit nacionalçlirimtar, duke kryer me hov funksione ekonomike, politike dhe propaganduese, që dëshmonte për dypushtetin e okupatorit dhe lëvizjes nacionalçlirimtare. Nga korriku i vitit 1944 shfaqen këshillat nacionalçlirimtare në nivel të fshatrave, komunave, qarqeve, qyteteve, rretheve dhe shteteve.

Burimi 3

Shtypi

Borba (Serbi), *Pobjeda* (Mali i Zi), *Omladinski Pokret* (Mali i Zi), *Osvobodilna fronta* (Slloveni), *Slobodna Vojvodina* (Serbi), *Reç naroda* (Serbi), *Vesti* (Serbi), *Mlad Borec* (Maqedoni), *Nova Makedonija* (Maqedoni) etj.

Burimi 5

Ekonomia e luftës

Në Uzhicen e lirë në vitin 1941 u ripërtëri fabrika e armëve e cila për 67 ditë prodhoi 21.040 pushkë, 18.000 bomba dore, 2.700.000 plumba pushke etj. Në Ozren partizanët bënë bomba dore nga gypat e ujësjellësit, me dorezë prej druri sipas së cilës e morën emrin "kallinj" sepse sipas pamjes i ngjanin kallirit të misrit. Nga mesi i shtatorit 1941, në Drvar filloi prodhimi në fabrikë i bombave si të Fabrikës Ushtarake në Kragujevac. Modelin e bëri mekaniku Millosh Bauk dhe ata e morën emrin sipas tij "baukovka", ndërsa kryengritësit e Likës i quanin "drvarase" sepse ata vinin nga Drvari. Llogaritet se janë prodhuar 6.000 bomba të këtij lloji. Në Çrmeç, në rrjedhën e lumit Suvajçina, është organizuar fabrika më e madhe partizane e armëve në Bosnje dhe Hercegovinë, e cila punoi deri në janar të vitit 1943. Në Petrova Gora që në tetor 1941 filloi me punë punësoria për prodhimin e bombave, riparimin e pushkëve etj. Në territorin e Malit të Zi kryengritës (në Rudine) gjithashtu punonin punëtori partizane: për këpucë, qepje të rrobave, për pushkë, për zdrukthetari. Në vende të caktuara të Jugosllavisë në territorin e lirë janë krijuar ferma kafshësh të cilat gjendeshin në pronësi të frontit nacionalçlirimtar. Në Mal të Zi, në hapësirën e Pives, në maj 1942 u themeluan fermat e kafshëve të cilat prodhonin qumësht dhe mish për luftëtarët, të plagosurit dhe të sëmurët. Ferma të këtilla, të krijuara në pjesën më të madhe me rekuizitë apo me anë të plaçkës, kishte 19. Numri i përgjithshëm i kafshëve në këto ferma ishte: 174 lopë për mjelje, 264 bagëti për mish, 1.497 dele për mjelje, 2.158 dele shterp, 392 dhi për mjelje dhe 311 dhi shterpë. Ekonomia partizane ("struga") në Prekaj është themeluar në pranverë të vitit 1942 nga kopeja e dhenve të cilën e dhanë pronarët e pasur. Pas kapitullimit të Italisë, në shtator të vitit 1943, në ishuj filluan të punojnë edhe kantieret e anijeve: në Vela Luka në Korçullë, në ishujt Braç, Hvar, Dugi Otok, Kornat, Izh, Vis dhe Lastovë. Nga fillimi i vitit 1943 deri në dhjetor 1944 në hapësirat e këtyre kantierëve të anijeve u sollën më pakë se 600 anije më të vogla për shkak të riparimeve.

Burimi 2

Shkollat

Për PKJ-në (Partinë Komuniste të Jugosllavisë) lufta për kulturën popullore dhe arsimimin popullor ishte pjesë përbërëse e luftës revolucionare. Së këndejmi edhe parulla aktuale: "Me arsimim drejt lirisë" dhe "Nuk janë armë vetëm pushkët dhe topat, aeroplanët dhe tanket, por edhe dija". Është e njohur parulla "Libri na ndihmon ta fitojmë lirinë, liria do të na mundësojë ta përvetësojmë librin". Puna kulturore-arsimore dhe kulturore-artistike vijonte në kuadër të njërive ushtarake partizane, në territoret e çliuara dhe në kuadër të veprimtarisë së organeve të pushtetit dhe organizatave antifashiste të grave dhe rinisë. Parimet dhe përmbajtja e politikës kulturore janë të njëjta në të gjitha pjesët e Jugosllavisë, duke dalluar vetëm në format specifike të cilat ishin shprehje e rrjedhave të ndryshme dhe rrethanave në të cilat është zhvilluar një popull i caktuar i Jugosllavisë dhe ligjit të pabarazisë së revolucionit jugosllav.

Burimi 4

Teatri

Luftëtarët me dhunti për punë kulturore-propagandistike u tërhoqën nga njësitë luftarake në njësitë artistike. Çeta e aradhes së Uzhices u ngrit në aktiv dramatik i cili shfaqti katër shfaqje teatrale në territorin e çliruar. Krahas ekipit dramatik në territorin e çliruar të "Republikës së Uzhices" në mënyrë aktive mbanin shfaqje këngëtarët dhe muzikantët. Orkestra e madhe kishte rreth 30 anëtar. Në përbërjen e tij kishte rreth 60 anëtarë themelues, prej të cilëve shumica ishin artistë dramatikë tanimë të njohur të cilët e lëshuan territorin e okupuar.

"Republika e Uzhices" është emërtimi i territorit në Serbinë perëndimore dhe pjesërisht në Bosnjën perëndimore të cilën partizanët mbanin në kontrollin e tyre nga dhjetori i vitit 1941 (me qendër qytetin e Uzhices).

Burimi 6

Fotografi dhe tekst për Ushtrinë Çlirimtare Partizane

Njësitë partizane u formuan në brigada. Në fotografinë 1 (majtas në skaj) Komandanti Suprem Tito, është duke e vëzhguar brigadën e parë "proletare". Fotografia 2 (djathtas në skaj) tregon rreshtimin e brigadës së katërt proletare malazeze.

Kobsa, Ljublanovi , Rasti : *Ilustrirana povjest NOB-a u Jugoslaviji 1941–1945, Stvarnost, Zagreb, 1973*



Burimi 1

Marshi i Igmanit ishte marsh i dhunshëm i Brigadës së Parë Proletare i realizuar me humbje të mëdha, në natën e 27 janarit 1942

Pararoja e kolonës arriti në rrëzën e malit Igman rreth orës 22. Duhej edhe pak kohë që kolona të futet në pyllin e Igmanit dhe atëherë të përfundojnë të gjitha rreziqet të cilat e kërcënonin brigadën, ndërsa kalonte pranë fortifikimeve të armikut. Porsa fillimi i kolonës doli në rrugën Sarajevë-Blazhuj, Batalioni i Parë e shpërndau çetën e II që ta sigurojë drejtimin nga Sarajeva, ndërsa pjesën III të çetës drejt Blazhujit. Në rrëzën e Igmanit brigada u nda nga udhëheqësit e saj – luftëtarët e çetës së Semizovacit të batalionit të Crnovrshit. Brigada më nuk ishte në rrezik, por ata ishin. Duhej të kthehen rrugës së njëjtë. Brigada u nis nga Igmani. Pa e arritur suksesin e plotë hasi në pengesë të re. Rruga nëpër Igman së pari është e pjerrët nga njëra anë, ndërsa pastaj, për rreth 300 metra nga rruga, kthen menjëherë, thujse vertikalisht për kodre. Në atë pjerrësi rruga ishte e akullt, ndërsa akulli i mbuluar me borë. Shumica rrëshqitën në të, binin dhe sërish me forcat e fundit, shpesh duke u zvarritur e tejkaluan atë akullnajë. Më e vështirë ishte të kalohet me kuajt e ngarkuar. Potkuat e tyre të vegjël boshnjakë, me thumba të vegjël, ose me potkua të vjetër, u “ndihmonin” më tepër kuajve që të rrëshqasin sesa të kalojnë nëpër akull. Në atë vend të rrezikshëm kolona ndalej dhe grumbullohej. Rreziku rritej. E tërë kolona, e ngjeshur në hapësirë të vogël, u gjend në pjesën e rrugës në Malin Igman dhe në rrugën Sarajevë – Blazhuj. Nga rruga ishte pastruar bora dhe në të mund të shfaqen automjetet e armikut.

Komandanti i brigadës Koça Popović erdhi të shohë pse u ndal kolona. Duke e parë arsyen, urdhëroi që me sëpata të thyhet akulli, ndërsa kuajt të shkarkohen. Luftëtarët i morën mitralozat, minahedhësit dhe pajisjet tjera, e mbanin në shpinë dhe i tërhiqnin kuajt nëpër atë pjerrësi. Aty njerëzit ishin më të qëndrueshëm se kuajt! Ndalesa në rrëzë të Igmanit, në ftohtësi që rrallë ndodh, ishte arsyeja kryesore e ngrirjes së numrit më të madh të luftëtarëve. Luftëtarëve u vite gjithnjë e më ftohtë. Më kot lëviznin dhe kërcenin në vend. As kjo më nuk ndihmonte. Disa luftëtarë nga fundi i kolonës të cilët ishin ende në fshat, nuk kishin mundësi ta durojnë të ftohtin gjithnjë e më të madh dhe u futën nëpër shtëpi që të ngrohen. Kjo u kushtoi shtrenjtë. U shkri bora nga këpucët e tyre, e cila u bë akull pasi dolën nga shtëpitë. Ndërsa atyre ushtarëve të cilët binin në pjerrësi, si dhe atyre të cilët i merrnin armët nga kuajt dhe i mbanin u ngrinë gishtat e dorës. Marshi nëpër Igman ishte i vështirë dhe bëhej më i vështirë edhe më shumë. Prurjet e borës ishin gjithnjë e më të mëdha, ndërsa rrugica edhe më e thellë. Nëse ndonjë luftëtar nuk shkelte mirë në borë, rrëshqiste dhe binte në borë të thellë. Lartë nga Igmani, luftëtarët i shihnin dritat në llixhë, Rajlovc dhe Sarajevë. E dinin që atje është ngrohtë, por edhe që atje është armiku. Sa më shumë që kolona ngjitej në mal, i ftohti bëhej më i ashpër. Para agimit shtrëngonte më shumë. Ndërsa kolona e partizanëve marshonte tanimë dhjetë orë pa pushim, e lodhur nga ditët paraprake, por edhe nga uria. Luftëtarët kishin gjithnjë e më pakë fuqi, ndërsa mali gjithnjë e më i vrazhdë dhe më i ftohtë. Luftëtarët e veshur më dobët e ndjenin më fuqishëm dimrin, edhe pse lëviznin. U jepte guxim shpresa që edhe këtë do ta kalojnë, njëjtë siç i ikën armikut në atë marsh të vështirë.

Fillimi i kolonës rreth orës 8 arriti në Veliko Polje. Aty ishte një shtëpi e madhe, e bukur malore në kat, shtabi i çetës partizane – çetnike të Igmanit. Çetnikët dhe partizanët në atë kohë ende bashkëpunonin në luftën kundër gjermanëve. Me mjaft përzemërsi e pritën brigadën, luftëtarëve u dhanë të hanë atë që kishin dhe u ndihmuan luftëtarëve të ngrirë që t'i nxjerrin këpucët. Luftëtarëve që kishin shkelë në përrua dhe atyre që ishin futur në shtëpitë në rrëzë të Igmanit ishte e vështirë t'ua nxjerrësh këpucët e ngrira. Infermieret, luftëtarët që nuk kishin ngrirë dhe partizanët e ndodhur pranë, të gjithë pa dallim, ua bënin masazh këmbët e ngrira.

Miloš Vuksanović "Prva proleterska brigada"; "Narodna knjiga" Beograd, "Pobjeda" Titograd; 1981. godina

Burimi 2

Nëpër malet e Bosnjës



Drago Mazar, Partizanski album, 4 jul, Beograd 1981


Burimi 3

Brigadës së Dytë Dalmatinase Tito i dha urdhër që gjatë natës të kalojë në anën tjetër të Neretvës, të bëjë urë të improvizuar nëpërmjet së cilës do të kalonte ushtria dhe të plagosurit. Duke i kthyer nga Shtabi Suprem, komandanti i brigadës Ljubo Vučković komandantit të Batalionit të Tretë, atëherë nëntëmbëdhjetë vjeçar Bruno Vuletiq, gjeneralit të ardhshëm të APJ-së (Armata Popullore Jugosllave), i urdhëroi që të përzgjedhë dhjetëshen që do ta realizojë urdhrin e Titos. Dhjetëshes i printe Glisho Opaçiq. Nga teli bënë rripe që i mbanin bombat italiane me fuqi të madhe shkatërruese... Dalmatinasit, edhe notues edhe trima – nuk e di a ishte ndonjëri mbi njëzet vjeç – kërcenin në Neretvën e akullt dhe të frikshme. Opaçiq, i cili në dhëmbë e mbante telin e hekurt, arriti ta lidh për bregun tjetër. Ishte natë dhe binte shi. Kur dhjetëshja e Opaçiut arriti në anën tjetër të Neretvës, ua hodhën bombat çetnikëve të cilët ikën, duke i lënë kuajt, ushqimin, municionin... Duke e shfrytëzuar telin, Glisha Opaçiq ndërtoi vendkalim të improvizuar nëpër Neretvë. Luftëtarët me të plagosurit ngadalë kalonin në bregun tjetër. Isha i shtatëmbëdhjeti në radhë...

Tamara Nikčević, Goli otoci Jova Kapičića, Daily Press, Podgorica, 2009

Burimi 4

Neretva



Kobsa, Ljubljanović, Rastić, ILUSTRIRANA POVJEST NOBa U JUGOSLAVIJI 1941-1945, Stvarnost, Zagreb, 1973.

Burimi 5

Varri im – Ivan Goran Kovačić

Në malin e errët le të jetë varri im,
mbi të le të ulërijë ujku, dhe zhurma e degës
së zezë

Verës shakullina e përjetshme, dimrit bora e
lartë,
por nga qetësia e varrit nuk ka ikje.

Lartë le të qëndrojë, si mjegull dhe fron,
mos të arrijë deri te ai zilja e kullës së vogël,
mos të arrijë deri te ai zëri vajtues,
frika e lutësit për shpëtim.

Le të rritet bari, nëpër shkurret me thera,
Asnjë rrugë mos të çojë te ai, i
padepërtueshëm, i pjerrët.
Askush të mos vijë, por miku i dashur ta gjejë,-
Dhe kur të shkojë, mos të lerë gjurmë pas tij.

Burimi 6

“Për fat të keq, me anë të detit nuk dërguam asgjë në
ndihmë të 222.000 luftëtarëve të Titos. (...) Këta
luftëtarë të qëndrueshëm lidhën me shumë gjermanë
në Jugosllavi sesa forcat e bashkuara anglo-
amerikane në Itali dhe në jug të Romës. Gjermanët
janë në huti pas rënies së Italisë, prandaj partizanët e
morën mbikëqyrjen mbi një pjesë të madhe të bregut.
Edhe krahas kësaj, ne nuk e shfrytëzuam rastin.
Gjermanët shpejtë e morën veten dhe i shtypën
partizanët hap pas hapi. Arsyeja kryesore e kësaj
është linja e panatyrshme e urdhërimit në Ballkan. (...)
Meqenëse partizanët nga ofruan ndihmë shpirtgjere
thuaje pa asnjë shpenzim nga ana jonë, ishte me
rëndësi të madhe të sigurohet qëndrueshmëria e
rezistencës së tyre”.

W. Churchill: Memoari, 24. novembra 1943.

Burimi 1

Në Ushtrinë Nacionalçlirimtare të Jugosllavisë luftonin mbi 100.000 gra, prej të cilave rreth 25.000 e humbën jetën. Rreth 40.000 gra, u plagosën gjatë Luftës Nacionalçlirimtare (LNÇ). Mbi 2.000 gra u bënë oficere në Ushtrinë Nacionalçlirimtare të Jugosllavisë. Gratë luftëtare ishin: delegate, komisarë politike, komandante, referente sanitare, infermiere, luftëtare, operues me mitraloz, bombarduese, udhëheqës partiakë të rinisë komuniste dhe udhëheqëse dhe anëtarë të Këshillave Nacionalçlirimtarë. Prej rreth 1.700.000 Jugosllavëve, që e humbën jetën gjatë Luftës së Dytë Botërore, rreth 620.000 ishin gra, ndërsa vetëm nëpër llogore u vranë mbi 282.000.

Prej 91 grave, që u shpallën hero populli, 73 prej tyre e humbën jetën gjatë LNÇ-së, ndërsa vetëm 17 prej tyre u dekoruan gjersa ishin gjallë. Hero i parë i popullit u shpall më 15 tetor 1943 Marija Bursaç, luftëtare – bombahedhëse e Brigadës së Dhjetë të Krajinës. Gruaja e parë që u dekorua si e gjallë me dekoratën e Heroit të Popullit ishte Spasenija Babović, e cila u dekorua më 5 korrik 1952.

Narodni heroji Jugoslavije, „Mladost“, Beograd 1975. godina

Burimi 2

Rajka Baković

Rajka lindi në familje të pasur të emigrantit nga ishulli i Braçit Frane Baković në qytezën boliviane të minatorëve Oruro, ku babai i saj me vëllanë kishin hotel dhe shitore. Familja në vitin 1921 u kthye në Jugosllavi për shkak të shkollimit të fëmijëve (Zdenka, Jarko, Rajko dhe Mladen). Pas shkollës fillore të cilën e mbaroi në Braç, Rajka me familjen u vendosën në Zagreb, ku babai bleu shtëpi (trekatëshe në rrugën Grunduliçeva nr. 25). Që si gjimnaziste Rajka u afrua me rininë me orientime të majta, kështu që në vitin 1938 u pranua në SKOJ (Lidhja e Rinisë Komuniste të Jugosllavisë). Vitin e njëjtë u regjistrua në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Zagrebit dhe në fakultet vazhdoi me aktivitetin politik, veçanërisht duke u aktivizuar në përgatitjet për zgjedhjet e vitit 1939. Edhe e tërë familja e saj, motra Zdenka, vëllezërit dhe nëna, ishin me orientim të majtë dhe aktive në të gjitha organizatat e lëvizjes punëtore klasore, kështu që Rajka së shpejti u bë e njohur te të gjithë komunistët e Zagrebit. Banesa e tyre u bë vendtakim i rinisë me orientim majtist, punëtorëve dhe intelektualëve. Pas vdekjes së babait, familja Baković ra në vështirësi financiare, për këtë arsye e bleu kioskën në rrugën Nikoliçeva nr. 7, pranë kinemasë së atëhershme (sot Teatri për të Rinj i Zagrebit).

Pas shpërthimit të luftës, kioska e tyre u bë vend për ndërlidhje të të gjithë ilegalëve partiakë, ndërsa e furnizonte me materiale dhe teknike Komitetin Qendror të Partisë Komuniste të Kroacisë, në të cilin punonte edhe vëllai i saj Jerko. Rajka ishte korrier i besueshëm i lëvizjes së rezistencës, dërgonte mesazhe në Beograd dhe qytetet të tjera, ndërsa vepronte edhe në aksionet e grupeve goditëse të SKOJ-ëve, siç ishte ndezja e stadiumit të drurit në Maksimir. Megjithatë, puna e tyre ilegale nuk mbeti e pahetuar, andaj në natën e 20 dhjetorit 1941 në banesën e familjes Baković u futën agjentët e Shërbimit Mbikëqyrës të Ustashëve (UNS), inspektuan dhe e arrestuan Zdenkën, Rajkën dhe vëllanë Mlladenin. Të dyja motrat u torturuan rëndë që t'i tregonin lidhjet e tyre. Natën torturoheshin, ndërsa gjatë ditës dërgoheshin në kioskë, që në atë mënyrë të gjuhen ilegalët të cilët do të shfaqeshin eventualisht, por kjo nuk i ndihmoi policisë. Motrat nuk e treguan asnjërin, edhe krahas rrahjeve të rënda. Pas mundimeve pesëditore Rajka më 24 dhjetor është dërguar në spital, ndërsa Zdenka të nesërmen, duke e parë që mungon motra e saj, në momente pikëllimi e shfrytëzoi momentin e moskujdesit të rojtarëve të saj dhe kërcëu nga kati i katërt i selisë së UNS-së në rrugën Zvonimir dhe vdiq. Rajka Baković vdiq si pasojë e mundimeve më 29 dhjetor 1941.”



Rajka Baković je 24. jula 1953. godine proglašena narodnim herojem SFR Jugoslavije.

Narodni heroji Jugoslavije“, „Mladost“ Beograd 1975. godina.

Burimi 3

Fana Koçevska Cvetkoviç

Lindi më 27 korrik 1927 në fshatin Llavci pranë Manastirit, në familje të varfër të mërgimtarit maqedonas. Pas okupimit të Jugosllavisë, në prill të vitit 1941 në fshatin Llavci ekzistonte organizatë e fuqishme partiake, në kuadër të së cilës funksiononte aktivi i lidhjes së rinisë komuniste anëtar i së cilës ishte edhe Koçevska e re. Okupatorët fashistë bullgarë arritën ta kapin një anëtar të aktivitetit të lidhjes së rinisë komuniste, i cili nuk i rezistoi mirë policisë, duke e zbuluar punën e organizatës dhe anëtarëve të saj. Fana arriti të ikë para policisë fashiste, e cila erdhi në fshat që ta gjejë, duke e kontrolluar shtëpinë dhe duke e keqtrajtuar nënën e saj dhe gjyshen.

Fana e vazhdoi punën e saj ilegale. Së shpejti më pas shkoi në aradhen partizane "Goce Dellçev". Atëherë nuk kishte as pesëmbëdhjetë vjet. Në pranverë të vitit 1944, Fana ishte pjesë e grupit prej shtatë luftëtarëve të cilët duhej ta ndërpresin prodhimin në heheroren e plumbit në Zletovë duke i shkatërruar pajisjet. Detyra ishte t'i sulmojnë bunkerët të cilët i mbanin fashistët gjermanë dhe bullgarë. Detyra u krye, por Fana u plagos. Shokët mezi shpëtuan nga rafali i armikut. Shtabi i brigadës vendosi ta lerë në shërim në fshat, me të plagosurit e tjerë. Fana refuzoi qëndrimin në fshat dhe mbeti edhe më tej në brigadë.

U shqua gjatë luftimeve në fshatin Llavci në vitin 1943, kur e humbën jetën komandanti i aradhes Toshio Angelovski Daskalot, bombahedhësi i ri Pande Hajze dhe disa shokë të tjerë. Duke u fshehur në rrethinën e fshatit Llavci rreth një muaj e gjysmë me një grup të partizanëve, Fana njëherë katër ditë mbeti vetëm, e rrethuar nga patrullat bullgare, të cilat ditë e natë bënin kontrollime dhe bastisje, duke e ditur se partizanët gjenden në afërsi. Fana ishte pjesëmarrëse e Fushatës së Shkurtit në vitin 1944, nga Kozhufi në Kozjak. Atëherë ishte udhëheqëse rinore e batalionit "Stiv Naumov".



"Narodni heroji Jugoslavije", "Mladost" Beograd 1975. godina.

Burimi 4

Vida Tomshiq

Lindi më 26 qershor 1913 në Lubjanë. Aty e mbaroi shkollën fillore dhe gjimnazin. Në vitin 1931 u regjistrua në Fakultetin Filozofik, por më vonë kaloi në Juridik, ku diplomoi në vitin 1941. Gjatë studimeve iu bashkëngjiti lëvizjes përparimtare studentore dhe morri pjesë në shumë greva.

Në vitin 1934 u bë anëtare e Partisë Komuniste të Jugosllavisë. Në vitin e njëjtë u njoh me burrin e saj të ardhshëm Anton Tonet Tomshiq, hero i popullit. Në nëntor të vitit 1934 u burgos dhe u gjykua pranë Gjyqit të Qarkut në Lubjanë me nëntë muaj burg. Pas daljes nga burgu, vazhdoi punën ilegale në organizatën partiake dhe pjesëmarrjen në lëvizjen studentore. Morri pjesë në shtypjen dhe përhapjen e gazetave dhe broshurave ilegale dhe legale. Një kohë të caktuar punoi si instruktor i Komitetit Qendror të Partisë Komuniste Sllovene (KQPKS) në regjionin Dolenjsk dhe Bela Krajina.

Në qershor të vitit 1940 në konferencën Krahinore u zgjodh si anëtare e KQ të PK Sllovene, ndërsa pastaj ushte në shkollën partiake pranë KQ të PK të Jugosllavisë në Makarskë. Në konferencën e pestë vendore të PKJ-së, në tetor 1940, u zgjodh si anëtare e Komitetit Qendror të PKJ-së.

Që nga ditët e para të okupimit të Mbretërisë Jugosllave, morri pjesë në përgatitjet për kryengritje të armatosur dhe punoi për forcimin e organizatave partiake në hapësirën e krahinës së Lubjanës. Në fillim të vitit 1941 morri pjesë në themelimin e gazetës legale partiake për gra "Nasha Zhena" (Gruaja jonë). Në Gusht të vitit të njëjtë, si ilegale për të cilën ishte shqiptuar masa e arrestimit lindi djalë. Me paraqitjen e një tradhtari, Italianët e arrestuan më 10 dhjetor 1941, bashkë me gruan Tonetën, nën emrin ilegal Marija Pevec. Në burg u torturua që ta pranojë punën ilegale dhe punën e burrit të saj, për të cilin ishin në dijeni që është njëri nga udhëheqësit kryesorë të kryengritjes. Nuk pranoi asgjë, e as emrin e saj të vërtetë. Pastaj, bashkë me burrin, Miho Marinkon dhe Pepco Kardelin, u dërgua në burgun e gestapos në Begunje, në regjionin e Gorenjskos, por gestapo pas dy muajve ua këtheu autoritetëve italiane.

Më 16 maj 1942 gjyqi ushtarak italian në procesin kundër Anton Tomshiqit dhe të tjerëve i dënoi me 25 vjet burg. Burrin e saj e pushkatuan, ndërsa atë në vitin 1942 e dërguan në burg në Venedik, pastaj në Ankonë, e më pas në Kampoboso dhe në Tran.

Pas kapitullimit të Italisë, bashkë me të burgosurit e tjerë, u soll në llogoren e drejtorisë ushtarake anglo-amerikane në Karbonara pranë Barit. Aty në llogore organizoi organizatë partiake dhe ishte mes themeluesve të Brigadës së Parë Përtejdetit, në të cilën një kohë ishte zëvendëse e komisarit politik.

Në janar të vitit 1944 u kthye në Slloveni. Nga prilli deri në tetor të vitit 1942 e redaktonte organin partiak "Ljudska piavica" (Të drejtat e njeriut) dhe publikonte punët organizative të Komitetit Qendror të PK të Sllovenisë. Në fillim të vitit 1945 u dërgua në regjionin e Primorskos në punë politike në ushtri, ku më 18 janar si anëtare e Politbyrosë të KQ të PKS-së, ndihmonte në punën e Komitetit të Zonës të PKS-së për zonën Slovensko Primorje dhe njësitë e Korpusit të Nëntë Slloven.

Pas çlirimit të Jugosllavisë Vida Tomshiq kryente funksione të rëndësishme. Në organet e pushtetit ishte ministre e politikës sociale të Qeverisë së Republikës Popullore të Sllovenisë, kryetare e Komisionit të Kontrollit të RP të Sllovenisë dhe anëtare e Kuvendit Ekzekutiv të RP të Sllovenisë.

"Narodni heroji Jugoslavije", "Mladost" Beograd 1975. godina.

Burimi 5

Shokët e Batalionit të Parë të Brigadës së Katërt Punuese, Sutjeskë, 1942.



Muzej Istorije Jugoslavije, inv. br. 13699.

Burimi 1

Urdhri i Titos

Për fat të keq, gjatë kohës së fundit ndodhin dukuri të tilla në disa prej njësive tona të cilat janë pa dinjitet për secilin që gjendet në radhët e ushtrisë. Me anë të marrjes me dhunë të ushqimit dhe bagëtisë nga fshatarët, si nga individët ashtu edhe nga organet përgjegjëse, prishet autoriteti i ushtrisë sonë si ushtri popullore, e gjithashtu krijohet në popull dhe qëndrim armiqësor kundër ushtrisë sonë, që mund, në kohë shumë të shkurtër, për ne të ketë pasoja katastrofale. Veprat e tilla shkojnë në dobi të armikut të përbetuar të popullit tonë dhe të ushtrisë sonë dhe u ndihmojnë që në atë mënyrë t'i arrijnë qëllimet e tyre të cilat nuk i kanë arritur deri tani me asnjë lloj arme.

URDHËROJ

1. Çdo dukuri e plaçkitjes dhe dhunës do të hetohet në themel dhe në rast se vërtetohet fajësia, fajtorët duhet të dënohen në rreshtin e pushkatimit.
4. Të merren të gjitha masat që në njësitet tona të vendoset ajo disiplinë e cila ka mbizotëruar deri tani, që pa pyetje të kryhen të gjitha urdhrat e eprorëve të autorizuar.

Burimi 2

Fakti që një numër i caktuar i luftëtarëve, por edhe i anëtarëve të parisë, sillet keq me popullatën (në çka shihet dobësia dhe pakujdesi e organizatës partiake dhe udhëheqjes), nëse lidhet me rastet e mëparshme të dezertimit, tregon se ende nuk janë gjallëruar dobësitë në organizatën tuaj partiake.

Burimi 3

Këtyre ditëve është pushkatuar Petar Krnjajiq, komandant i mëparshëm i çetës sonë dhe komandant i mëparshëm i Batalionit të Parë... Pas sulmit në Prekop është thirrur në shtabin e Zonës së Parë Operative që të jap llogari për vendimin e tij që fshati të digjet dhe të gjithë meshkujt mbi gjashtëmbëdhjetë-vjet të vriten.

Burimi 1, 2, dhe 3: D. Lazarević, P. Damjanović, *O partiji i ulozu komunista*, Knjiga 2 Institut za savremenu istoriju u Beogradu, Narodna Knjiga, Beograd, 1984.

Burimi 4

Më 17 korrik 1942, në orën 21:30 u futën 15 partizanë të armatosur në fshatin Sreser, 4 km në veri të Janjinës, fshatarëve të atjeshëm u morën gjësende të ndryshme dhe para, edhe atë: Tomisllav Matijasheviq Stepanovit, nga Shën Marija, komuna e Drashkovacit, rrethi i Varauzdinit, udhëtar tregtues, tani përkohësisht i vendosur në Sreser, partizanët i morën 34.070 kuna para të gatshme, 4 shami, 5 palë çorapë dhe gjëra të tjera të imëta, të cilat nuk kishte mundësi t'i përshkruajë saktësisht, me vlerë prej 3.000 kuna dhe pas kësaj u larguan nga banesa.

Nga Tomisllav Nozhica (djali i Vllahos), tregtar nga Sreseri, partizanët morën 20 kg patate, një thes për patate, 2 litra vaj, 1 proshutë, 1 tenxhere për gatim prej 6 litrave, 30 metra penj, 2 pasta dhëmbësh, 2 brusha dhëmbësh, 10 brisqe për t'u ruajtur, 800 cigare Rama, 2.000 kuna para të gatshme, gjithsejtë me vlerë prej 6.000 kuna. Ata kërkuan 100.000 kuna para të gatshme, por ai nuk kishte, pastaj u larguan nga shtëpia.

Nga Pero (Ante) Kuçera nga Sreseri, pronar toke, partizanët morën 20 kg miell gruri dhe e kërcënuan, se nëse u shërben italianëve, do ta vrasin. Të tretë i kërcënuan që të mos i tregojnë askujt asgjë, sepse do ta humbin kokën.

Një grup i partizanëve prej dhjetë personave konfiskoi dhjetë qe nga blegtori hercegovas Mishka Papac, më 27 gusht, në kodrën Shën Ilia, në lindje të fshatit Nakovnja. Papac këtë ngjarje ia paraqiti autoriteteve të Orebiqit.

Sve naše Dakse, Joška Radica, Dubrovnik, 2003. str. 69.

Burimi 5

Në prill u vranë dy komunistë të cilët arritën të iknin nga burgu i çetnikëve (Radimir Jovančević dhe Miodrag Medo Čulafiq), sepse si partizanë kishin lejuar të bien të gjallë në duart e armikut klasor dhe t'i njollosin armët partizane. Në Crnicë është vranë gjenerali sanitet Milo Ličković bashkë me gruan e tij ruse, si edhe Bosa Plamenac, anëtare e Partisë Komuniste të Jugosllavisë (PKJ) se nuk dëshironte të heq dorë nga familja e saj. Në Piva është likuiduar Tadija Tadiq me tre familjarë, komisar politik të çetës nga Piva, sepse nuk dëshironte ta dorëzojë xhaxhanë... Shumë vrasje të tjera të ngjashme, të cilat kishin karakter të likuidimit sepse paraprakisht ishte shqiptuar dënimi, krijuan atmosferë të frikës dhe terrorit në të cilën askush nuk e dinte kush është i ardhshmi. Atavizmi i treguar dhe ashpërsia është vështirë të sqarohen me fraza ideologjike. Mes tjerash, dukuri të këtilla thuhet nuk kishte në viset tjera të Jugosllavisë, pa e marrë parasysh atë që direktiva e Komitetit Qendror të PKJ-së zbatohen nëpërmjet të gjitha organizatave partiake.

Živko M. Andrijašević-Šerbo Rastoder, Istorija Crne Gore, CZICG, Podgorica 2006., str. 413-414

Pyetje për debat përfundimtar:

1. Cilat aktivitete i kryenin partizanët në territoret e çliuara?
2. Çka dëshironin të arrijnë ata në territoret e çliuara?
3. Çfarë pasojash, pozitive apo negative, mundnin të shkaktojnë aksionet e tyre?